



Thirrje e hapur

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) në bashkëpunim me Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (FDUT), me mbështetjen e Programit për Forcimin e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri – JuST (USAID), është duke zbatuar projektin me titull, “*Fuqizimi i lëndës së Klinikës së Ligjit pranë Fakultetit të Drejtësisë, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve dhe aftësive praktike të studentëve në ofrimin e shërbimit ligjor për shtresat në nevojë*”. Ky projekt, krahas bashkëpunimit me Klinikën e Ligjit, ka si objektiv ofrimin e mundësive të aftësimit praktik për studentët të FDUT-së.

Në kuadër të zbatimit të këtij projekti, shpallet kjo thirrje e hapur për të ftuar studentët të aplikojnë për të qenë pjesë e skuadrës së re *pro bono*, pranë QNL-së. Numri i studentëve që do të pranohen është 50, të cilët të ndarë në tre skuadra *pro bono*, do të japin ndihmesën e tyre gjatë vitit 2015. Studentët e përzgjedhur do të angazhohen në ndjekjen e rasteve konkrete, informimin dhe këshillimin ligjor për çështje të ndryshme ligjore në mbështetje të personave në nevojë, në monitorimin e seancave të ndryshme gjyqësore, etj.

Ftojme të gjithë studentët e vitit të II, Masteri Civil, Masteri Penal dhe Masteri Publik, të shprehin interesin e tyre në lidhje me këtë thirrje, nëpërmjet paraqitjes së një kërkesë pranë QNL-së, në adresën tonë të e-mailit: avkatore2@yahoo.com, ose në mjediset e Qendrës, në adresën: Rr. “Vaso Pasha”, P.12, Shk.1, Ap.1, Tiranë, Shqipëri.

Do të përzgjidhen anëtarë të skuadrës së re *pro bono*, studentë që nuk frekuentojnë lëndën e Klinikës së Ligjit, pasi këta të fundit janë aktivizuar në një program tjetër të këtij projekti.

Afati përfundimtar i shprehjes së interesit është data 12 Dhjetor, 2014.

